VENDIM
Nr. 990, datë 9.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 138 e 142, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, të miratuar me vendimin nr. 424, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në shërbim të politikave të arsimit të lartë ministria përgjegjëse për arsimin mund të kërkojë vlerësimin e jashtëm të cilësisë së institucioneve e të programeve të studimit nga agjenci të tjera vlerësimi, që janë anëtare me të drejta të plota të Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ose të Regjistrit Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (EQAR). Vlerësimi i jashtëm dhe konsulenca për kryerjen e këtij vlerësimi nga këto agjenci kryhet me qëllim akreditimin e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë. Vlerësimi i jashtëm nga këto agjenci kryhet në përputhje edhe me standardet e procedurat vendase për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.".

b) Në fund të pikës 1, të nenit 5, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1 Agjencia e huaj, pjesë e ENQA-s e EQAR-it, kontraktohet drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me tarifat e përcaktuara në këtë rregullore për vlerësim të jashtëm të cilësisë së programit/programeve të studimit apo të institucionit/institucioneve të arsimit të lartë dhe konsulencë për kryerjen e këtij vlerësimi.".

2. Në nenin 9/1 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët"... tabelat nr. 1 dhe nr. 2, ..." zëvendësohen me "... tabelat nr. 1.1 dhe tabela nr. 2.1 ...".

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

"3. Pagesat për konsulencë për agjencitë e huaja të vlerësimit kryhen në bazë të tarifës ditore 700 euro/dita për çdo ekspert të huaj të angazhuar, por jo më shumë sesa 10 ditë pune për çdo ekspert të huaj. Ekspertëve të huaj të angazhuar nga agjencia e huaj e vlerësimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

4. Pagesat për agjencitë e huaja të vlerësimit për akreditimin e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë bëhen mbështetur në pagesat mbi bazë eksperti, sipas pikës 2, të këtij neni, ku agjencia e huaj e vlerësimit mund të ketë shumicën e ekspertëve në grupet e vlerësimit. Ekspertëve të vlerësimit të angazhuar nga agjencia e huaj e vlerësimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama